



- Të Reja ▾Policia e Shtetit ▾Historik i shkurtër i Policisë së shtetit shqiptarShërbime ▾Baza ligjoreVendndodhjet e policisëVideo
- Programi i transparencës ▾KontaktDenonco Krimin KibernetikDrejtoritë Vendore të Policisë ▾Policia Kufitare ▾Policia Rugore ▾
- DonacioneRubrika Policimi në Komunitet ▾Përmbledhja JavorePër sinjalizimin

Breaking News: Raporti i ngjarjeve, 4 janar 2024

DVP Korçë/Vihen në pranga 4 shtetas dhe procedohen në gjendje të lirë 2 të tjerë, për vepra të ndryshme penale

HAPEN APLIKIMET PËR PRANIM NË DISA FUNKSIONE NDIHMËSE NË POLICINË E SHTETIT

Fier – Goditet një rast i veprimtarisë kriminale të dhënies ndihmë emigrantëve, për kalim të paligjshëm të kufirit

Elbasan/Vijon operacioni policor mbarëkombëtar i koduar “Sundimi i ligjit”



04/01/2024

DVP Dibër – Finalizohet Me Sukses Operacioni Policor I Koduar “Eksplozivi”

DVP Dibër/Finalizohet me sukses operacioni policor i koduar “Eksplozivi”.

Vendosi lëndë eksplozive në afërsi të banesës dhe dyqanit të një 54-vjeçari, Policia zbardh në kohë rekord ngjarjen, identifikon dhe arreston autorin e dyshuar.

Autori i dyshuar, një 42-vjeçar(i dënuar më parë për disa vepra penale, dhe aktualisht vuan dënimin alternativ ‘Shërbim prove’).

Sekuestrohen një armë zjarri pushkë, 87 copë fishek, 4 granata dore, 5 copë ndezëse granatash, 4 metër fitil zjarrpërcjellës, 2 targa të një automjeti në pronësi të një shtetasi tjetër dhe një aparat celular.

Strukturat hetimore të Drejtorisë Vendore të Policisë Dibër, në bashkëpunim me shërbimet e Komisarariatit të Policisë Mat, në vijim të punës për zbardhjen dhe dokumentimin e ngjarjes së ndodhur në mesnatë në lagjen “Drita”, në qytetin e Burrelit, bazuar dhe në informacionet e siguruara nga intelijenca informative, kanë organizuar dhe finalizuar me sukses operacionin policor të koduar “Eksplozivi”.

Si rezultat i këtij operacioni u bë arrestimi i shtetasit E. L., 42 vjeç, banues në Burrel, i dënuar më parë për disa vepra penale në fushën e krimeve ndaj personit dhe pasurisë, dhe aktualisht vuante dënimin alternativ ‘Shërbim prove’.

Nga veprimet hetimore dhe provat e siguruara dyshohet se 42-vjeçari, për shkak të një konflikti të mëparshëm me shtetasin A.C., ka shkuar pranë banesës së këtij të fundit, ku ka vendosur dhe ka shpëthyer një sasi e vogël lëndë plasëse eksploziv pa shkaktuar dëme.

Gjithashtu, në portën hyrëse të dyqanit të shtetasit A.C., ka vendosur një tjetër sasi lëndë plasëse eksploziv, dhe nga shpërthimi janë shkaktuar dëme të vogla materiale.

Në cilësinë e provës materiale, 42-vjeçarit, iu gjetën dhe sekuestruan një armë zjarri pushkë, 87 copë fishek, 4 granata dore, 5 copë ndezëse granatash, 4 metër fitil zjarrpërcjellës, 2 targa të një automjeti në pronësi të një shtetasi tjetër dhe një aparat celular.

Ky shtetas, dyshohet se është autor dhe i disa ngjarjeve të mëparshme me eksploziv në Burrel, për të cilin në bashkëpunim me Prokurorinë vijnë hetimet intensive për zbardhjen dhe grumbullimin e provave, si dhe identifikimin e kapjen e bashkautorëve të tjerë të përfshirë në këto ngjarje.

Materialet i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, për veprime të mëtejshme.

Kërko

Enter a word for search



Komisariati Dixhital

GET IT ON
Google Play

Download on the
App Store

Arkiva

Select Month

Linqe

- > Arkiva
- > Akademia e Sigurisë
- > Ministria e Brendshme
- > Agjencia e Mbikëqyrjes Policore
- > Interpol
- > Europol
- > Misioni PAMECA V
- > SCPA
- > Projekti Trivalent

◀ Pogradec – Finalizohet operacioni i koduar “Taksisti”, sekuestrohen 8.2 kg kanabis dhe 1 armë zjarri

Elbasan/Vijon operacioni policor mbarëkombëtar i koduar “Sundimi i ligjit” ▶